

Çfarë të bëni nëse dikush në punë ka COVID-19

Nëse dikush në punë ka COVID-19, ose nëse ka mundësi të ekspozoheni, duhet që menjëherë të ndjekni hapat në vijim. Mos pritni që të konfirmohet se ata kanë COVID-19.

Ky informacion është për t'ju ndihmuar juve në vendin e punës. Sidoqoftë, duhet që gjithmonë të ndjekni këshillimin e departamentit publik të shëndetësisë të shtetit apo territorit tuaj ([state or territory public health department](#)).

Nëse një person ka një simptom serioz siç është vështirësi në frymëmarrje, thirrni 000.

1. Izoloni personin

Izoloni personin nga të tjerët. Gjithmonë duhet t'i siguronit ata, dhe çdo kush që i ndihmon atyre, me mjete mbrojtëse personale të përshtatshme siç është maska kirurgjike për një pëdorim dhe sanitizuesi i duarve.

2. Kërkoni këshillë dhe vlerësoni rreziqet

Kërkoni këshillë shëndetësore qeveritare nga linja për ndihmë e shtetit apo territorit tuaj ([state or territory helpline](#)), ose nga linja kombëtare për koronavirusin (1800 020 080).

Sigurohuni që të keni informacionet për kontakt të personit. Bëni një shënim për hapësirat në vendin e punës, me të cilat ata kanë qenë në kontakt, sa gjatë, për t'ju informuar për rreziqet ndaj të tjerëve dhe hapësirat që duhet të pastrohen dhe dezinfektohen.

Gjithasthu duhet të njoftoni rregullatorin shëndetësorë dhe të sigurisë së shtetit apo territorit tuaj ([state or territory work health and safety regulator](#)).

3. Transporti

Sigurohuni që personi të ketë transport deri në shtëpinë e tij, lokacionin për t'u siguruar, apo deri tek një hapësirë mjekësore nëse është e nevojshme. Kur do që të jetë e mundshme, ata duhet të përdorin një mënyrë personale të transportit për të minimizuar ekspozimin e të tjerëve.

4. Pastroni dhe dezinfektoni

Mbyllni hapësirat që i ka përdorur personi për derisa ato të pastrohen dhe dezinfektohen. Hapni dyert e jashtme dhe dritaret nëse është e mundur për të rritur rrjedhën e ajrit.

Plotësisht pastroni dhe dezinfektoni hapësirat dhe mjetet që i ka përdorur personi, siç janë zyrat, banjot, kuzhinat dhe hapësirat e përbashkëta.

Pastruesit duhet të mbajnë mjete mbrojtëse personale të duhura, për shembull doreza, mbrojtëse të syve dhe përparëse për një përdorim.

5. Identifikoni dhe tregoni kontaktet e afërta

Njësia e shëndetit publik e shtetit apo territorit do të identifikon kontaktet e afërta të rastit të konfirmuar me COVID-19 dhe do t'u tregon tyre se çfarë duhet të bëjnë.

Zbuloni se cili person ka qenë në kontakt me atë në vendin e punës dhe për sa gjatë, dhe se kur kontaktet e afërta të personit të prekur kanë qenë në vendin e punës.

Kjo do t'ju informon juve në lidhje me rreziqet e mundshme ndaj të tjerëve, dhe për hapësirat tjera që mund të ketë nevojë për t'i pastruar dhe dezinfektuar.

6. Shqyrtoni kontrollet e menaxhimit të rrezikut

Shqyrtoni kontrollet tuaja të menaxhimit të rrezikut për COVID-19 në konsultim me punëtorët tuaj dhe vlerësoni nëse është e nevojshme të bëni ndryshime.

Hapat që duhet marrur kur personi në fjalë ka qenë në vendin e punës kohët e fundit

Personi që kohët e fundit ka qenë një vendin e punës, siç është një punëtor apo klient, mund t'ju informon se mund të ketë COVID-19. Keni parasysh kohën që ata kanë qenë në punë dhe nëse kanë pasur kontakt të afërt me të tjerët.

Edhe nëse ata nuk janë momentalisht në vendin e punës, prapë mund të jetë e nevojshme të ndjekni hapat e lartpërmendur. Kërkoni këshillë nga linja për ndihmë në shtetin apo territorin tuaj ([state or territory helpline](#)).

A ka nevojë të mbyll vendin tim të punës?

Nuk ka ndonjë kërkesë automatike për mbyllje pas një rasti të dyshimtë apo të konfirmuar me COVID-19. Kjo mund të jetë e panevojshme nëse personi ka vizituar vetëm disa pjesë të vendit tuaj të punës apo nëse zyrtarët e shëndetit ju këshillojnë se rreziku i ekspozimit është i ulët.

Nëse vendi juaj i punës duhet të mbyllet varet nga faktorët siç është madhësia, natyra e punës, numri i njerëzve dhe hapësirat e dyshimta të kontaminuara.

Kur mund të kthehen punëtorët në punë pas shërimit apo karantinës?

Punëtorët që janë izoluar pas testit pozitiv për COVID-19 mund të kthehen në punë vetëm kur të shërohen plotësisht dhe të kontrollohen nga zyrtarët e shëndetit.

Punëtorët që nuk kanë pasur simptoma gjatë karantinës mund të kthehen në punë pasi të kenë kaluar periudhën prej 14 ditëve. Nuk ka nevojë për kontroll mjekësorë që ata të kthehen në punë.

Më shumë informacione

Për më shumë informacione, vizitoni [Safe Work Australia website](https://www.swa.gov.au/coronavirus).